



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses më 23 prill pranoi tërheqjen e një prej viktimave nga pjesëmarrja në proces. Trupi Gjykses konstatoi se viktimat nuk duhet të ishte detyruar të merrte pjesë në proces.

Më 29 prill, Trupi Gjykses rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për të apeluar një urdhër gojor me të cilin u hodh poshtë një kërkesë e mëparshme e Mbrojtjes që ZPS-ja të urdhërohej të nxirrte të gjitha shënimet nga takimi përgatitor me një dëshmitar, për të kuptuar se cili dokument i referohej dëshmitari gjatë dëshmisë së tij. Trupi Gjykses konstatoi se ishte e qartë se dokumenti të cilit i referohej dëshmitari dhe që u bë shkas për refuzimin për të dhënë dëshmi ishte deklarata që i njëjti dëshmitar kishte dhënë në 2001. Këtë deklaratë Mbrojtja tashmë e kishte marrë.

Më 29 prill, Trupi Gjykses rrëzoi kërkesën e përbashkët të ekipeve të Mbrojtjes për leje për të apeluar pranimin në prova të deklaratës së mëparshme të një prej dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria. Duke mbajtur parasysh refuzimin e dëshmitarit për t'iu përgjigjur pyetjeve të Prokurorisë, pavarësisht paralajmërimeve dhe udhëzimeve nga Trupi Gjykses, ky i fundit u bind se Prokuroria nuk mund t'i bënte pyetje dëshmitarit lidhur me deklaratën e mëparshme dhe, për rrjedhojë, e pranoi deklaratën në fjalë si provë. Trupi Gjykses vuri në dukje se Mbrojtja pati mundësi t'i bënte pyetje dëshmitarit lidhur me deklaratën përkatëse. Trupi Gjykses theksoi se në një fazë të mëvonshme do të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në deklaratat e tij duke marrë parasysh tërësinë e provave të administruara në gjykim.





Në vijim të mbylljes së provave nga Prokuroria më 15 prill, Ligji përcakton se Mbrojtjes i jepet mundësia të kërkojë rrëzimin e të gjitha akuzave, ose ndonjë prej akuzave, në Aktakuzë. Në konferencën mbi ecurinë e çështjes të mbajtur rishtazi, ekipet e Mbrojtjes deklaruan se synojnë të bëjnë kërkesë të përbashkët për rrëzimin e akuzave. Trupi Gjykues caktoi si afat 2 qershorin, ose 14 ditë pas vendimit të fundit të Trupit Gjykues për pranimin e provave në këtë çështje gjyqësore. Prokurorisë do t'i jepen 30 ditë për t'iu përgjigjur kërkesës së tyre. Pasi Trupi Gjykues të vendosë lidhur me kërkesën, do të paraqesë provat e veta mbrojtësi i viktimave.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit lidhur me ndikimin e pretenduar ndaj dëshmitarëve, më 15 prill Hashim Thaçi u vetëdeklarua "i pafajshëm" me shkrim lidhur me të gjithë akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar, të ndryshuar, përfshirë edhe lidhur me formën shtesë të nxitjes, të konfirmuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake më 14 prill.

Më 24 prill, Kryetare Ekaterina Trendafilova, caktoi Panelin e Apelit për të vendosur mbi kërkesën e Fadil Fazliut për zgjatje të afatit me 14 ditë për dorëzimin e apelit kundër vendimit mbi vazhdimin e paraburgimit të tij nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake. Paneli i Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Nina Jorgensen.

Më 25 prill, Paneli i Apelit rrëzoi mocionin e z. Fazliu me konstatimin se ai kishte hequr dorë nga e drejta për të apeluar vendimin për vazhdimin e paraburgimit nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, pasi kërkesën për kohë shtesë e dorëzoi pesë ditë pas afatit dhe nuk paraqiti apo demonstroi arsye të vlefshme për vonesën e kërkesës, apo për nevojën për zgjatjen e afatit për dorëzimin e apelit. Duke mbajtur parasysh se arsyet për vazhdimin e paraburgimit të z. Fazliu rishikohen çdo dy muaj dhe meqë afati i Mbrojtjes për dorëzimin e parashtrimeve për rishikimin e ardhshëm është 5 maji, Paneli i Apelit ishte i mendimit se mosshqyrtimi i apelit nuk shkakton gabim gjyqësor.





Më 24 prill 2025, Kryetare Ekaterina Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi kërkesën referuese të Salih Mustafës, të dorëzuar prej tij po atë ditë, në të cilën pretendonte shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore. Kërkesa e tij referuese vjen pas vendimit më të fundit të Gjykatës Supreme të 25 shkurtit. Paneli i Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga gjykatësit Vidar Stensland, Rumen Nenkov, dhe Pjotr Hofmanski.

